



KOLEGJI "BIZNESI"
Nr. 314/22 Data 04.08.2022
PRISHTINE



MARRËVESHJE DHE PROTOKOL EKZEKUTIV MBI ZBRITJEN E TARIFAVE PËR STUDIME

Lidhur mes:

1. Kolegjit **BIZNESI**, me seli ligjore në Prishtinë dhe (degën në Prizren), rruga Motrat Qiriazit nr.18, i përfaqësuar nga dekani Prof. Dr. Shyqeri Kabashi.
dhe

2. Sindikatës të Policisë së Kosovës (SPK), Rr. Luan Haradinaj pn, 10.000 Prishtinë, Republika e Kosovës Tel & Fax Tel. 038/ 50801256 përfaqësuar nga kryetari z. Imer Zeqiri.

Të cilët pajtohen si vijon:

Neni 1

Qëllimi i kësaj marrëveshje është arritja e pajtueshmërisë për zbritjen e tarifave vjetore për studime në arsimin e lartë për anëtarët e SPK-së dhe familjarët e tyre.

Kjo marrëveshje nuk do të aplikohet për tarifa të tjera të cilat nuk konsiderohen si tarifa vjetore për studime. Marrëveshja lidhet në afat kohor prej 5 (pesë) vite.

Neni 2

Sindikatës e Policisë së Kosovës duhet t'ia dorëzojë Administratës së Kolegjit BIZNESI, listën e të interesuarve për të studiuar.

Lista e kandidatëve për studimet Bachelor për vitin akademik 2022/2023 duhet të dorëzohet deri më **01 Tetor 2022**, ndërsa lista e kandidatëve për studimet Master për vitin akademik 2022/2023, duhet të dorëzohet deri më **01 Nëntor 2022**.

Listat e dorëzuara nga Sindikata e Policisë së Kosovës (SPK) duhet të përmbajnë: numrin e protokollit, emrin dhe mbiemrin e zyrtarit si dhe datën e vendin e lindjes. Në fund të dokumentit, Sindikata e Policisë së Kosovës, duhet të deklarojë shprehimisht që personat, emrat e të cilëve janë të përfshirë në listat e dorëzuara, janë anëtarë të SPK-së apo familjarë të tyre.

Neni 3

Kolegji BIZNESI obligohet që, pas marrjes së listave nga ana e Sindikatës të Policisë së Kosovës, të mos kërkojë dokumente shtesë lidhur me pozitën zyrtare të kandidatëve por vetëm dokumentet e nevojshme ligjore për regjistrim.

Anëtarët e Sindikatës të Policisë së Kosovës dhe familjarët do të gëzojnë një zbritje nga 1000 në 800 euro, të shumës vjetore të tarifave universitare të aplikuara për studimet Bachelor dhe nga 1200 në 1000 euro, të shumës vjetore të tarifave universitare të aplikuara për studimet Master.

Për sqarim të dispozitave të kësaj marrëveshje, familjarë konsiderohen: babai, nëna, motra, vëllai, bashkëshortja dhe fëmijët e anëtarëve të Sindikatës të Policisë së Kosovës.

Neni 4

Familjarët e anëtarëve të SPK-së, do të jenë përfutues të kësaj marrëveshje pavarësisht faktit nëse anëtar i SPK-së, do të regjistrohet apo jo në Kolegjin BIZNESI.

Në rast se anëtar i SPK-ë, ka bërë kërkesë për regjistrim në bazë të listave të dorëzuara nga SPK, atëherë familjari duhet të dëshmojë lidhjen familjare me zyrtarin në fjalë nëpërmjet paraqitjes së dokumenteve përkatëse të gjendjes civile (certifikatë lindjeje ose martese).

Në rast se vetë anëtar i SPK-së nuk ka bërë kërkesë për regjistrim, atëherë familjari duhet të pajiset paraprakisht me një vërtetim mbi anëtarësinë e zyrtarit policor në Sindikatën e Pavarur të Policisë së Kosovës, të vulosur nga Sindikata e Policisë së Kosovës, si dhe të dëshmojë lidhjen familjare me zyrtarin në fjalë nëpërmjet paraqitjes së dokumenteve përkatës të gjendjes civile (certifikatë lindjeje ose martese).

Neni 5

Kolegji BIZNESI Prishtinë, për të gjithë fëmijët, prindërit e të cilëve kanë ra në detyrë, ofron shkollimin pa pagesë.

Neni 6

Administrata e Kolegjit BIZNESI, pas pranimit të aplikimit për regjistrim nga ana e zyrtarit të Policisë së Kosovës ose të familjarëve të tij, do të nxjerrë një vendim mbi reduktimin tarifor. Ky vendim do të përmbajë numrin e protokollit, tarifën vjetore të paraparë për atë drejtim studimi, përqindjen e zbritjes së aplikuar si edhe shumën totale për t'u paguar, e cila mund të paguhet edhe me këste mujore.

Mundësia e pagesës me këste mujore nuk do të paragjykojë, në asnjë mënyrë, zbritjen e aplikuar në bazë të kësaj marrëveshje.

Neni 7

Kolegji BIZNESI angazhohet që të krijojë të gjithë infrastrukturën e nevojshme administrative mbi mbarëvajtjen e obligimeve të kësaj marrëveshje, si dhe të caktojë një referent i cili do të jetë përgjegjës për koordinimin e zhvillimeve të marrëdhënies kontraktuale dhe ekzekutive, me Sindikatën e Policisë së Kosovës.

Sindikata e Pavarur e Policisë së Kosovës angazhohet që të informojë anëtarët e saj, mbi mundësinë e parashikuar në këtë Marrëveshje si dhe të caktojë personin e autorizuar i cili do të jetë përgjegjës për koordinimin e zhvillimeve të marrëdhënies kontraktuale dhe ekzekutive me Kolegjin BIZNESI.

Neni 8

Në bazë të kësaj marrëveshje, anëtarët e Sindikatës të Policisë së Kosovës dhe familjarët e tyre, do të gëzojnë zbritje të tarifave universitare të aplikuara për studimet Bachelor dhe Master në Kolegjin BIZNESI, deri në përfundim të studimeve të filluara në bazë të kësaj marrëveshje.

Marrëveshja mund të shkëputet nga secila palë me paralajmërim paraprak me shkrim prej 90 ditësh. Zgjidhja e marrëveshjes nuk do të ketë asnjë efekt, as retroaktiv, mbi privilegjin e arritur si edhe mbi vendimin administrativ të parashikuar nga neni 6 i kësaj Marrëveshje.

Në rast të zgjidhjes së marrëveshjes, anëtarët e Sindikatës të Policisë së Kosovës apo familjarët e tyre, do të vazhdojnë të gëzojnë zbritjet e aplikuara deri në përfundimin e studimeve.

Në rast mosmarrëveshjeje lidhur me aplikimin e dispozitave të kësaj marrëveshjeje, palët bien dakort që të njëjtat t'i zgjidhin me mirëbesim përmes një organi negociues të përbërë nga katër anëtarë: dy nga Sindikata e Policisë së Kosovës dhe dy nga Kolegji BIZNESI. Vetëm pas dështimit

të gjetjes së një zgjidhjeje të përbashkët palët bien dakort që kompetenca t'i kalojë për shqyrtim gjyqësor civil Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Neni 9

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të saj nga përfaqësuesit e të dy institucioneve.

Prishtinë, më 04/08/2022.

Për Kolegjin BIZNESI:
Prof Dr. Shqipri Kabashi



A circular blue stamp with the text "KOLEGJI BIZNESI" around the perimeter and "BIZNESI" at the bottom. The center contains a logo with the letters "KB". A blue ink signature is written over the stamp.

Për Sindikatat e Policisë së Kosovës:
Z. Imer Zeqiri



A circular blue stamp with the text "SINDIKATAT E POLICIE SE KOSOVES" around the perimeter and "PRISHTINE" at the bottom. The center contains a logo with a sun and a shield. A blue ink signature is written over the stamp.

Apliko online
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
+38338500878
+38344500878
+38345500878
+38349500878
+38348500878
+38344200681
+38344610878
+38329230555
+38344131027



Kolegji BIZNESI College

Licencuar nga MASHT
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
Akredituar nga AKA
Agjencia e Kosovës për Akreditim

18

vjet!

vend i dijës dhe i suksesit

www.kolegjbiznesi.com

#Regjistrimet

Prishtinë - Prizren

Për ne...



Kolegji "BIZNESI" i themeluar në vitin 2004, është institucion privat i arsimit të lartë, Bartës Privat i Arsimit të Lartë (BPrAL) në Kosovë. Themelimi i Kolegjit "BIZNESI" është i bazuar në Rregulloren nr. 2003/04 për shpalljen e Ligjit mbi arsimin e lartë, të miratuar nga Kuvendi i Kosovës, dhe në Udhëzimin Administrativ mbi Licencimin e Bartësve Privat të Arsimit të Lartë në Kosovë, nr. 14/2003. Kolegji "BIZNESI" është i licencuar nga Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, me Vendimin nr. 464/10. Pas përgatitjeve të plota teknike, angazhimit të personelit akademikë dhe administrativë, sipas normave ligjore, Kolegji "BIZNESI" ka filluar punën në vitin akademik 2005/06. Në Kolegjin "BIZNESI" kanë studiuar me sukses disa gjenerata të studentëve. Kolegji "BIZNESI" veprimtarinë akademike e zhvillon në fushën e studimeve Ekonomike, Juridike dhe Emergjencave, në dy nivele, niveli Bachelor dhe niveli Master, si dhe programe profesionale të nivelit të III-të të KKK-së. Në Kolegjin "BIZNESI", numri i përgjithshëm i studentëve të regjistruar gjatë këtyre viteve akademike, është mbi 13.500 studentë.

Fjala e rektorit



Prof. dr. Shyqeri Kabashi

Të dashur maturantë!

Suksesi juaj në provimin e maturës është një dritare e hapur më shumë për perspektivën tuaj për zgjerimin e horizonteve të dijes, për fillimin e karrierës suaj jetësore. Kolegji BIZNESI, është një mundësi tjetër për realizimin e ëndrrës suaj për një karrierë të suksesshme të nxënies së dijes dhe të arritjes së majave të suksesit jetësor.

Kolegji BIZNESI, tashmë po krijon traditë.

Maturantë të suksesshëm! Vazhdojeni suksesin tuaj në Kolegjin BIZNESI! Fillojeni karrierën tuaj në studimet ekonomike, juridike dhe të emergjencave, që të bëheni profesionistë të së nesërme, për veten tuaj, për mjedisin shoqëror dhe për zhvillimin e Kosovës.

Kolegji BIZNESI i ka dyert e hapura për ju!
Ju, hapni dritaret e dijes dhe të suksesit!

Me respekt!
Prof. dr. Shyqeri Kabashi

Programet e studimit

Kolegji "BIZNESI" ka për qëllim ngritjen e shkathtësive profesionale të studentëve në fushën e biznesit, drejtësisë dhe emergjencave duke ndërlidhur teorinë bashkëkohore me praktikën adekuate.

BACHELOR

1. Banka dhe financa në biznes

2. Menaxhment Biznesi
(Menaxhment, Biznes Ndërkombëtar,
Marketing dhe komunikim)

3. Menaxhimi i emergjencave
(Mbrojtja në punë, Mbrojtja nga zjarri
Mbrojtja e ambientit)

4. Juridik i përgjithshëm
(Administrativ-kushtetues, Penal-juridik
Civil-juridik, Penologji dhe ekzekutimi
i sanksioneve penale)

MASTER

1. Menaxhment dhe financa
2. Menaxhimi i emergjencave

Niveli III i KKK-së

1. Teknik i mbrojtjes nga zjarri


Njohjet ndërkombëtare

Diploma e Kolegjit Biznesi njihen në të gjitha vendet e botës. Kolegji Biznesi nga vendet e rajonit, ka marr akte të veçanta juridike për njohjen e diplomave të Kolegjit Biznesi.

Pra, të gjithë studentët e vendeve të rajonit mund të kryejnë studimet në Kolegjin Biznesi me diplome të njohur nga këto vende.



Shqipëri



Gjermani



KULTUSMINISTER
KONFERENZ
Zentrum für ausländisches
Bildungswesen

Zugriffsbewertung für ausländische Hochschulqualifikationen

Die Bewertung erfolgt unter der Voraussetzung der Echtheit und Richtigkeit des Zeugnisses.

Herr **Laufim** geboren am 15.04.1991 in Prizren, weist den folgenden ausländischen Hochschulabschluss nach:

Abschluss: Bachelor / Artine në menaxhim e emergjencave
Wirtl. Übersetzung: Bachelor der Erdste in Notfallmanagement
Studiengang: Menaxhim i emergjencave (Notfallmanagement)
Fächerkombi: Menaxhimi i punëve (Arbeitschutz)
Institution: Kolegji Biznesi (Biznesi-Kolleg)
Ort: Prishtina
Land: Kosovo

Dauer: 3 Jahre
Abschlussdatum: 12.01.2015
Ausstellungsdatum: 03.03.2015
Urteilsnummer: **100**

Bewertung:
Der ausländische Abschluss entspricht formal einem deutschen Hochschulabschluss auf Bachelor-Ebene.



